

URDHËR
Nr. 5, datë 21.1.2020

**PËR ZGJATJEN E VLEFSHMËRISË SË KARTËS SË INSPEKTORIT EDHE GJATË
VITIT 2020, DERI NË RISTRUKTURIMIN E INSPEKTORATEVE SHTETËRORE/
TRUPAVE INSPEKTUESE**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, kreut V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik *e-Inspektimi*;

URDHËROJ:

1. Zgjatjen e vlefshmërisë së kartës së inspektorit të prodhuar sipas urdhrit nr. 32/1, datë 15.7.2016, me periudhë vlefshmërie deri më 31.12.2019, edhe gjatë vitit kalendarik 2020, deri në ristrukturimin e inspektorateve/trupave inspektuese.

2. Për çdo emërim të ri në detyrë, inspektori do të pajiset me kartën e inspektorit pranë Inspektoratit Qendror.

3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore/ trupat inspektuese për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe ju njoftohet inspektorateve shtetërore/ trupave inspektuese.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari